



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

KONTRATË PËR SHËRBIME (DRAFT)

Titulli: Ofrimi i Shërbimeve për Realizimin e Dokumentarit

Numri i Referencës së Kontratës: KWN-SC- ##-2026

Kjo Kontratë është lidhur ndërmjet:

Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK) (në tekstin e mëtejme Autoriteti Kontraktues)

Numri i regjistrimit: 5102267-0

Numri fiskal: 600238332

Adresa: Rr. Kadri Gjata, Kati I, nr. 8, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Përfaqësuar nga: Drejtorja Ekzekutive e RrGK-së

Emaili: info@womensnetwork.org

Tel.: +383 (0) 48 245 850

Dhe

Emri (i referuar më poshtë si Kontraktuesi)

Gjendet në:

Numri Fiskal:

Përfaqësuar nga:

Emaili:

Telefoni:

Neni 1. Qëllimi

Qëllimi i këtij shërbimi është angazhimi i një individi, OJQ ose kompanie profesionale për realizimin e një dokumentari, i cili do të dokumentojë historinë, zhvillimin, arritjet dhe kontributin e RrGK-së në avancimin e të drejtave të grave dhe barazisë gjinore në Kosovë, në përputhje me kërkesat dhe standardet e përcaktuara nga RrGK. Dokumentar do të shërbejë si material për aktivitete publike, transmetim mediatic dhe komunikim institucional.

Neni 2. Përgjegjësitë dhe rezultatet

Kontraktuesi raporton te Drejtoresha Ekzekutive e Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK) dhe është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve në përputhje me Termat e Referencës (ToR), të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj kontrate, si dhe me ofertën teknike dhe financiare të paraqitur dhe të pranuar nga RrGK.

Neni 3. Periudha e kontratës

Periudha e performancës është caktuar nga 25 Gusht 2026 deri më 30 Nëntor 2026.

Neni 4. Vendi i kryerjes së shërbimeve

Ofruesi i Shërbimeve i kryen shërbimet në vendin e zgjedhur prej tij/saj, në përputhje me përgjegjësitë e përcaktuara në këtë kontratë.

Neni 5. Vlera e kontratës dhe pagesat

Kjo është një Kontratë me çmimin për njësi. Pagesat do të kryhen pas marrjes së faturës përfundimtare brenda shtatë (7) ditëve pas ofrimit të Shërbimeve për kënaqësinë e plotë të Autoritetit Kontraktues.

Pagesat do të kryhen si më poshtë:

Emri Bankës:

Mbajtësi i llogarisë:

Numri i llogarisë:

Neni 6. Pronësia e produktit

Autoriteti Kontraktues gëzon të drejtën e plotë të pronësisë mbi produktin përfundimtar të realizuar në bazë të kësaj kontrate. Autoriteti Kontraktues ka të drejtën e plotë ta publikojë, kopjojë dhe shpërndajë produktin përfundimtar.

Neni 7. Përfundimi i Kontratës

Kjo kontratë do të përfundojë:

- Pas përfundimit me sukses të rezultateve të parashikuara.
- Me marrëveshje me shkrim midis palëve kontraktuese para përfundimit të periudhës së projektit dhe/ose përfundimit të të gjitha aktiviteteve të projektit; ose
- Për shkak të pamundësisë së njëres ose të dy palëve për të kryer detyrimet e tyre kontraktuale (p.sh., forca madhore, çështjet administrative). Nëse, për çfarëdo arsye, detyrimet e kësaj marrëveshjeje nuk do të përmbushen, secila nga palët mund të anulojë menjëherë marrëveshjen. Kur marrëveshja të përfundojë, shuma e papërdorur do t'i kthehet Autoritetit Kontraktues.

Neni 8. Konfidencialiteti

Kjo Kontratë është konfidenciale dhe nuk do të vihet në dispozicion të publikut pa pëlqimin e Palëve, përveç rasteve të parashikuara me ligjet përkatëse kombëtare. Gjatë zbatimit të Kontratës, dhe pas skadimit të saj, Kontraktuesi duhet të demonstrojë diskrecion të plotë dhe të mbajë konfidencial të gjithë informacionin në lidhje me biznesin e Autoritetit Kontraktues dhe çdo informacion në lidhje me punën e kryer si pjesë e Kontratës. Kjo nuk do të zbatohet për deklaratat ose faktet në dispozicion të publikut, ose deklaratat ose faktet natyra e të cilave nuk kërkon leje. Kontraktuesi pranon se çdo shkelje e konfidencialitetit do të përbëjë shkelje të rëndë dhe mund të rezultojë në përfundimin e menjëhershëm të kësaj Kontrate.

Neni 9. Udhëzimet mjedisore

Kontraktuesi do të marrë parasysh ndikimin mjedisor të të gjitha aspekteve të këtij projekti, të cilat mund të përfshijnë prodhimin, transportin, paketimin, përdorimin dhe asgjësimin e mallrave dhe shërbimeve në mënyrë jo ndotëse. Kontraktuesi pajtohet të përpiqet të blejë produkte dhe shërbime që kanë më pak ndikim negativ në mjedis, si dhe të kufizojë përdorimin e burimeve ku është e mundur (p.sh., energjia elektrike, uji, benzina dhe shmangia e produkteve plastike).

Neni 10. Ligji i aplikueshëm

Kjo kontratë i nënshtrohet dhe do të interpretohet në të gjitha aspektet në pajtim me Ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës.

Neni 11. Zgjidhja e kontestit

Palët Kontraktuese do të përpiqen që të gjitha çështjet që lindin sipas kësaj kontrate të zgjidhen me pëlqimin e ndërsjellë. Nëse një zgjidhje e tillë nuk është e mundur, do të përdoret jurisdiksioni i Gjykatës në Prishtinë, Republika e Kosovës.

Neni 12. Kopjet e Kontratës

Kjo kontratë është hartuar në dy (2) kopje identike. Secila palë do të marrë një (1) kopje origjinale të kontratës së nënshkruar.

Data dhe nënshkrimi

Data dhe nënshkrimi

Autoriteti kontraktues

Për Kontraktuesin

Nicole Farnsworth
Drejtoreshë Ekzekutive
Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK)

Emri
Titulli
Biznesi/OJQ/Individ